



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.11.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ALBI COMPANY" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Odës së Zejtarëve", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-11056-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-123-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik "ALBI COMPANY" SH.P.K, e dt.08.11.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i Odës së Zejtarëve", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-11056-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-123-521, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 22.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË e publikuara me datë: **22.10.2024;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "ALBI COMPANY" SH.P.K., me dt.08.11.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Odës së Zejtarëve", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-11056-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-123-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara, sepse Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, për këtë aktivitet të prokurimit, është në bashkëfinancim me Bashkimin Evropian dhe Bashkinë e Lezhës. Oda e Zejtarëve, ndodhet në një zonë të Çarshisë së Madhe e cila është e mbrojtur nga Ministria e Kulturës, gjë që e bën këtë projekt kompleks.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka kryer një analizë të thelluar të këtij aktiviteti të prokurimit dhe ka vlerësuar se vendosja e kriterëve është në përputhje me kushtet teknike dhe profesionale minimale të kërkuara për një aktivitet të tillë, që është specifik dhe ka karakteristika të veçanta.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

